

 <b>SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR</b>	<b>RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I KURRIKULËS E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-010-AL	01.10.2012	-	-	1 / 10

## **KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Objekti i Rregullores**

Rregullorja e studimeve Master Shkencor në Menaxhim Arsimor, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës përcakton parimet e funksionimit të këtij programi.

### **Neni 2 Baza Ligjore**


Rregullorja e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë të Shkollës së Lartë “ Hëna e plotë” (Bedër) mbështetet në ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10307, datë 22.07.2010 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, “Për licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë “Shkolla e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër), në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 03.04.2008 “Për hapjen dhe organizimin e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë në institucionet publike të arsimit të lartë”, në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 15, datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” si dhe në Statutin dhe Rregulloren Themelore të këtij institucioni.

## **KREU 2 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

### **Neni 3 Objektivat Formues Specifikë të Programit**

Programi i Masterit të Shkencave në Menaxhim Arsimor, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës është një fushë e cila analizon administrimin arsimor, menaxhimin e kurrikulave, marrëdhëniet midis organizatave dhe aktiviteteve arsimore si dhe marrëdhëniet midis saj dhe planifikimit të buxhetit në arsim. Programi përbëhet prej lëndëve me përmbajtje të programeve të avancuara në menaxhimin arsimor dhe atë të kurrikulës të ndërthurura me element gjuhësor si dhe nga lëndë të studimeve kërkimore. Studentët zhvillojnë aftësitë e të shprehurit me shkrim, me gojë si dhe ato të mendimit kritik.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 <b>SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR</b>	<b>RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I KURRIKULËS E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	2 / 10

**PLANIMESIMOR  
MASTER NE MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I KURRIKULËS**

<b>Semestri I</b>									
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Lloji i lëndës	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	PS D	Metodat e Hulumtimit në Shkencat Sociale	E detyruar	Anglisht	B	64	86	3.5	6
2	LED 403	Administrim Arsimit	E detyruar	Anglisht	B	64	86	3.5	6
3	LED 437	Menaxhim i Kurrikulave	E detyruar	Anglisht	B	64	86	3.5	6
4	LED 435	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore në Arsim	E detyruar	Anglisht	C	64	86	3.5	6
5		Lëndë me Zgjedhje	Me zgjedhje			64	86	3.5	6
<b>Gjithsej</b>						320	430	17.5	30

<b>Semestri II</b>									
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Lloji i lëndës	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	LED 402	Mbikqyerja në Arsim	E detyruar	Anglisht	B	64	86	3.5	6
2	LED 412	Pedagogji	E detyruar	Anglisht	B	64	86	3.5	6
3	LED 426	Planifikimi i Buxhetit në Arsim	E detyruar	Anglisht	D	64	86	3.5	6
4	LED 436	Vlerësimi i Aktivitetev e Arsimore	E detyruar	Anglisht	D	64	86	3.5	6
5		Lëndë me Zgjedhje	Me Zgjedhje			64	86	3.5	6
<b>Gjithsej</b>						320	430	17.5	30

<b>Semestri III</b>									
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Lloji i lëndës	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 <b>SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR</b>	<b>RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I KURRIKULËS E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	3 / 10

1	LED 511	Seminar Pasuniversitar	E detyruar	Anglisht	A	80	120	4	8
2	LED 503	Planifikimi dhe Vlerësimi në Mësimdhënie	E detyruar	Anglisht	B	80	120	4	8
3	LED 539	Teoritë Bashkëkohore të Personalitetit	E detyruar	Anglisht	B	80	120	4	8
4		Lëndë me Zgjedhje	Me Zgjedhje			80	70	4	6
<b>Gjithsej</b>						320	430	16	30


#### Semestri IV

Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Lloji i lëndës	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	LED 610	Tezë	E detyrueshme	Anglisht	F	320	430	10	30
<b>Gjithsej</b>						320	430	10	30

#### Lëndët me zgjedhje

Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Lloji i lëndës	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	LED 441	Kultura Shkolllore dhe Drejtimi	Me zgjedhje	Anglisht	D	80	70	4	6
2	LED 444	Udhëheqja në Organizatat Arsimore	Me zgjedhje	Anglisht	D	80	70	4	6
3	LED 446	Bazat e Administrimit dhe Mbikqyrjes në Arsim	Me zgjedhje	Anglisht	D	80	70	4	6
4	LED 447	Hulumtim dhe Shkrim Akademik	Me zgjedhje	Anglisht	D	80	70	4	6
5	LED 448	Përditësimi i Menaxhimit në Organizatat Arsimore	Me zgjedhje	Anglisht	D	80	70	4	6
6	LED 449	Arsimi i Moshave të Rritura	Me zgjedhje	Anglisht	D	80	70	4	6

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 <b>SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR</b>	<b>RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I KURRIKULËS E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	4 / 10

7	LED 450	Bazat Sociale të Administrimit dhe Mbikqyrjes në Arsim	Me zgjedhje	Anglisht	D	80	70	4	6
---	------------	---	-------------	----------	---	----	----	---	---

Menaxhimi Arsimit, Planifikimi dhe Zhvillimi i Kurrikulës është një fushë ndërdisiplinore e shkencës që studion mësuesinë, menaxhimin në arsim, dhe planifikimin e kurrikulës. Ky program synon të përfshijë të gjitha aspektet praktike dhe teorike të fushës së studimit dhe synon të pajisë studentët me një sfond teorik për t'u bërë ekspertë në shkencat e arsimit.

Programi përgatit specialistë të aftë për të planifikuar dhe zhvilluar kurrikulën, për menaxhim arsimor si dhe mësuesi me aftësi të shkëlqyera. Studentët që mbarojnë Programet e Studimit Master Shkencor në Menaxhim Arsimit, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës do të kenë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale në poste të ndryshme të organizatave publike apo private. Studentët të cilët kanë qenë të punësuar në institucione të ndryshme publike, apo private do të kenë mundësi pozicionim më të lartë se pozicioni i tyre aktual.

#### **Neni 4 Organizimi i Studimeve**

Studimet e Ciklit të Dytë në Master i Shkencave në Menaxhim Arsimit, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës zhvillohen në sistemin me kohë të plotë. Programi i studimeve realizohet me 120 ECTS, në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Shkencave të Edukimit, me vendim të Këshillit të Administrimit të Fakultetit dhe miratuar me vendim të Senatit të shkollës së lartë.

#### **Neni 5 Gjuha e Studimeve**


Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze.

#### **Neni 6 Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese**

Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtarive të tjera formuese të programit është si më poshtë:

**T** - Orë Teorike

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 <b>SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR</b>	<b>RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I KURRIKULËS E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	5 / 10

**P** - Orë Praktike

**K** - Kredite sipas Sistemit Amerikan

**ECTS** - Kredite sipas Sistemit ECTS

**PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT “MASTER I SHKENCAVE” NË MENAXHIM ARSIMOR,  
PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I KURRIKULËS**

Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A):	8 ECTS
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B):	46 ECTS
Formimi në disiplina të Ngjashme dhe/ose integrale (C):	6 ECTS
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D):	42 ECTS
Teza e Diplomës (F):	30 ECTS

**Neni 7**

**Kurrikulat dhe Objektivat Formues Specifikë të Çdo Veprimtarie Formuese**

Kurrikulat e ofruara për studentët gjatë programit si dhe objektivat formues specifikë të çdo veprimtarie formuese gjenden në tekstin bashkëngjitur.

**Neni 8**

**Kreditet dhe Detyrimet Penguese Për Çdo Disiplinë Mësimore apo Veprimtari Tjetër Formuese**

Programet e Studimit të Ciklit të Parë që mundësojnë pranimin në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë

Master i Shkencave në Menaxhim Arsimor, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës:

a. Pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	Shkenca Edukimi	0 Kredite

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
---	--	---------------------------

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 <b>SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR</b>	<b>RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I KURRIKULËS E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	6 / 10

Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	1. Pedagogji	0 Kredite
	2. Menaxhim Klase	0 Kredite
	3. Pune sociale	0 Kredite
	4. Psikologji	0 Kredite
	5. Programe të ngjashme studimi	0 Kredite

b. Me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë		Lëndët	Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	Departamenti i Shkencave të Edukimit	1. Parimet e Këshillimit dhe Pedagogjisë	5 ECTS
	Departamenti i Shkencave të Komunikimit	2. Psikologji Edukimit	5 ECTS
	Departamenti i Shkencave Islame	3. Menaxhim Klase	5 ECTS
	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke	4. Sociologji Edukimit	5 ECTS
	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze	5. Çështjet Etike, Ligjore dhe Profesionale në Këshillim	5 ECTS
		6. Edukimi Special	5 ECTS
	<b>Totali</b>	<b>5 Lëndë</b>	<b>25 ECTS</b>

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë


**RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË  
MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I  
KURRIKULËS E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË”  
(BEDËR)**

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	01.10.2012	-	-	7 / 10

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Lëndët	Kreditë për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	Psikologji Psikologji shkollore Punë sociale	1. Parimet e Këshillimit dhe Pedagogjisë	5 ECTS
		2. Menaxhim i Klasës	5 ECTS
		3. Çështjet Etike, Ligjore dhe Profesionale në Këshillim	5 ECTS
		4. Edukimi Special	5 ECTS
		5. Filozofia dhe Teoria e Edukimit	5 ECTS
	<b>Totali</b>	<b>5 Lëndë</b>	<b>25 ECTS</b>

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Lëndët	Kreditë për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	Shkenca Natyrore Ekonomi Gazetari Programe të ngjashme studimi	1. Parimet e Këshillimit dhe Pedagogjisë	5 ECTS
		2. Psikologji Edukimit	5 ECTS
		3. Menaxhim Klase	5 ECTS
		4. Çështjet Etike, Ligjore dhe Profesionale në Këshillim	5 ECTS
		5. Edukimi Special	5 ECTS
		6. Filozofia dhe Teoria e	5 ECTS

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	<b>RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË          MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I          KURRIKULËS E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË”          (BEDËR)</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	8 / 10

		Edukimit	
		7. Hyrje në Pedagogji	5 ECTS
	<b>Totali</b>	<b>6 Lëndë</b>	<b>30 ECTS</b>

### Neni 9 Njohja e Krediteve për Njohuri të Fituara më Parë

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Komiteti Shkencor mund të njohë si kredite të formimeve universitare në Programin e Masterit të Shkencave në Studimeve të Ciklit të Dytë në Menaxhim Arsimor, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës deri në 40 kredite të njohurive të veprimtarive formuese të fituara më parë nga studenti, të cilat janë në përputhje me objektivat specifike të programit.

### Neni 10 Forma e Studimit, Provimet dhe Verifikimeve të Tjera të Dijeve të Fituara nga Studentët

Programi përbëhet nga 14 lëndë dhe teza e diplomës, e cila zhvillohet në përfundim të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë. Në një vit akademik realizohen të paktën 60 kredi ECTS.


Procesi mësimor përbëhet nga leksionet dhe seminarët të cilat jepen në mënyrë të integruar, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme të parashikuara në programin mësimor.

Vlerësimi nga pikëpamja akademike për leksionet/seminarët, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse orë të zhvilluar në auditor. Vlera e krediteve të një lënde përbëhet nga shuma e të gjithë orëve javore të leksioneve teorike javore dhe sa gjysma e orëve javore të aplikimeve, laboratoreve, projekteve dhe punës në klasë.

Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale/vjetore, provimeve të fundvitit, detyrave të kursit, prezantimeve, aktivizimeve dhe projekteve. Me propozim të drejtuesit të programit përkatës dhe vendim të Komitetit Shkencor, studentit i jepet e drejta të hyjë në provim nëse nuk ka hyrë gjatë vitit për shkakë të arsyeshme dhe të dokumentuara brenda pesë ditëve.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë



 <b>SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR</b>	<b>RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I KURRIKULËS E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	9 / 10

### **Neni 11 Frekuentimi**

Studenti në program ka detyrimin të ndjekë të paktën 70% të aktiviteteve mësimore kërkimore të zhvilluara në auditor, të lëndëve teorike dhe të aktiviteteve mësimorë kërkimore. Studentët të cilët tejkalojnë këto norma duhet ta rimarrin përsëri atë lëndë me të gjitha detyrimet përkatëse.

Plotësimi apo jo i kushteve në lidhje me pjesëmarrjen, i paraqitet koordinatorit të programit nga ana e pedagogut të lëndës çdo muaj dhe kontrollohet nga Përgjegjësi i Departamentit.

### **Neni 12 Transferimi i studentëve**

Kuotat për transferimet në Programin Master i Shkencave në Menaxhim Arsimor, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës përcaktohen nga Komiteti Shkencor dhe miratohen nga Këshilli i Administrimit i Fakultetit, duke u bazuar në parimet e vendosura nga ky Këshill.


Studentëve të cilët janë transferuar në këtë program u jepet diplomë me kusht që të kenë kryer të paktën një semestër në Shkollën e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër). Studentët që kanë kryer një semestër në një program të studimit të ciklit të dytë, mund të aplikojnë pranë Sekretarisë Mësimore brenda afateve të caktuara në kalendarin akademik, për t’u transferuar në Programin Master Shkencor në Menaxhim Arsimor, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës, në përputhje me parimet e vendosura nga ana e Senatit. Kërkesa shqyrtohet nga Komiteti Shkencor i programit dhe Këshilli i Administrimit të Fakultetit merr vendim.

### **Neni 13 Numri i studentëve**

Numri minimal i studentëve në Programin Master i Shkencave në Menaxhim Arsimor, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës është gjashtë (6) dhe ai maksimal është pesëdhjetë (50) në një vit akademik.

Për t’u pranuar në programin e studimeve Master i Shkencave në Menaxhim Arsimor, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës çdo shtetas shqiptar që aplikon nevojitet të ketë përfunduar studimet për një diplomë universitare të nivelit Bachelor me rezultate të mira. Preferohen ata studentë që kanë mbaruar ciklin e studimeve të nivelit Bachelor në Shkenca Edukimi ose të ngjashme. Vlerësimi i titujve është kompetencë e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe bëhet me procedura publike. Synohet që me

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 <b>SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR</b>	<b>RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË MENAXHIM ARSIMOR, PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM I KURRIKULËS E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	10 / 10

nivelin e lartë profesional të stafit që do të përfshihet në realizimin e këtij programi, të tërhiqen studentët të huaj për të kryer kërkime shkencore pranë këtij departamenti.

### **Neni 14 Udhëheqja e Tezës**

Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Udhëheqësi i tezës ka të paktën gradën shkencore „Doktor i Shkencave”. Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

### **Neni 15 Niveli i Gjuhës Angleze**

Studentët e programit të studimit në fjalë japin deri në diplomim provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe Programet e Integruara të Studimeve të Ciklit të Dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve.

## **KREU 3 DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 16 Zbatimi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj në Këshillin e Lartë të Shkollës së Lartë.

Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Rektori.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

